



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPSTINA-STIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

02Nr. 31

Datë: 13.03.2019

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika g të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, nenit 54 dhe 61, të Statutit të Komunës së Shtimes, neni 22 i Rregullores Nr.09/2012 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Shtetërore, Propozimit të nënkomisionit për këshillim dhe konsultim për çështje të resurseve njerzore Nr.02/1-19 datë 13.3.2019, Kryetari i komunës së Shtimes bie këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Sistematizimi i Vendeve të Punës në Administratën Komunale për vitin 2019, si dhe Organogrami i Administratës Komunale sipas propozimit të Nënkomisionit për Këshillim dhe Konsultim.
2. Obligohet Zyra e Personelit që të bëjë plotësim - ndryshimin e aktemërimeve dhe përshkrimin e detyrave të punës sipas dokumentit mbi Sistematizimin e Vendeve të Punës.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij

A r s y e t i m

Kryetari i komunës me vendim nr.02/47 datë 15.2.2018 ka themeluar nënkomisionin për këshillim dhe konsultim, i cili komision pas një angazhimi permanent ka dhënë një propozim të arsyeshëm dhe të bazuar lidhur me sistematizimin e vendeve të punës, andaj, kryetari i komunës si të tillë e aprovon duke u bazuar në dispozitat ligjore nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, nenit 54 pika 5, të Statutit të Komunës së Shtimes.

Nga të cekurat më lart u vendosin dispozitiv të këtij vendimi

Iu dërgohet:

- Njesisë së Personelit;
- Në dosje.

